

J. Y. Polanushaj  
23.10.20

KUVENDI  
NR 1705 DATE 23.10.20



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_ .2020

Lënda : Amendament

Z.Gramoz RUÇI

KRYETAR I KUVENDIT

I nderuar z.Kryetar,

Mbështetur në nenin 75 pika 4 të Rregullores së Kuvendit propozojmë që në projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar, të shtohet amendimi si më poshtë vijon :

Pas nenit 5 të projektligjit, të shtohet një nen i ri, i riemërtuar si nen 6, që ndryshon pikën 1 të nenit 49 të ligjit aktual, ku të hiqet kufizimi i viteve për rikthimin në strukturat e policisë , duke u riformuluar si më poshtë vijon:

“Neni 6

Nenin 49 pika 1 ndryshohet si më poshtë:

1.“Një person rikthehet në polici, në rastet kur është liruar sipas arsyeve të parashikuara në nenin 46 pika 2. gërmat “e”; “ç”. Rikthimi në polici mund të bëhet në çdo kohë vetëm për nevoja të Policisë së Shtetit dhe nëse personi plotëson kërkesat e poshtëshënuara:

a) Kalon me sukses procesin e vlerësimit kalimtar sipas procedurës së parashikuar në ligjin nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar;

b) Plotëson kriteret ligjore dhe profesionale të pozicionit të punës.

## *Relacion*

E drejta e ushtrimit të profesionit është një e drejtë e cila sanksionohet edhe në Kushtetutë dhe askujt nuk mund ti hiqet me ligj. Me përjashtim të rasteve, kur një shtetas është i dënuar për vepra penale të ndryshme apo është përjashtuar pas procesit të vetingut me arsyetimin si i papërshtatshëm.

Prandaj edhe gjatë diskutimeve në Komisionin për Sigurinë Kombëtare, do të kërkonim që pas nenit 5 të projektligjit, të shtohet një nen i ri, i riemërtuar si neni 6, që ndryshon nenin 49 të ligjit aktual **“Rikthimi në polici”, pika 1**, duke hequr përkufizimin e rikthimit në polici vetëm nëse ai ka ndërprerë marrëdhëniet e punës me strukturat e Policisë së Shtetit brenda 2 vjetëve të fundit, pasi duke e hequr këtë kufizim, ne krijojmë mundësinë e plotësimit të vendeve vakante me persona, të cilët janë të aftë dhe plotësojnë kriteret për të shërbyer përsëri në strukturat e Policisë së Shtetit.

## **DEPUTETËT**

Arbëreshë Ahmeti

[Shqiptarja.com]

J. 4. Parlamentar  
Të ligjvënës  
te 27.10.20

NR 2757 DATE 27.10.20



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI

Tiranë më 27.10.2020

PROPOZIME PËR AMENDAMENTE  
PËR PROJEKTLIGJIN "PËR POLICINË E SHTETIT"

Drejtuar : **Zotit GRAMOZ RUÇI**  
**KRYETAR I KUVENDIT TË SHQIPËRISË**

Bazuar në nenin 75, pika 4, të Rregullores së Kuvendit, paraqesim amendamentet e mëposhtme në projektligjin "Për Policinë e Shtetit", mbi tekstin integral të miratuar nga Komisioni Përgjegjës për Sigurinë Kombëtare, si më poshtë :

1. Në nenin 2 të projektligjit, i cili shton nenin 7/1, " Komiteti Kombëtar i Politikave për Parandalimin dhe Luftën Kundër Krimit të Organizuar ", në variantin e miratuar nga Komisioni për Sigurinë Kombëtare, pika 3 të ndryshohet me këtë përmbajtje:

*"3. Komiteti kryesohet nga përfaqësuesi i Ministrisë së Brendshme dhe ka në përbërje përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, përfaqësues të Prokurorisë së Përgjithshme dhe të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, përfaqësues të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, të Agjencisë përgjegjëse për luftën kundër terrorizmit dhe Agjencisë përgjegjëse për pastrimin e parave".*

Ky ndryshim propozohet për të reflektuar në ligj pavarësinë e Institucioneve të pavarura, siç është Prokuroria e Përgjithshme, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, si dhe ndarjen dhe balancimin e pushteteve, me qëllim shmangien e çdo ndikimi të mundshëm apo krijimin e ndonjë perceptimi publik për ndikim në vendimmarrjet e tyre.

2. Në nenin 7 të projektligjit, i cili ndryshon nenin 131 “Masa të veçanta”, në variantin e miratuar nga Komisioni për Sigurinë Kombëtare, pika 1, paragrafi i parë të ndryshohet, me këtë përmbajtje:

*"1. Gjatë veprimtarisë informative-gjurmuese, me qëllim parandalimin e veprave penale, zbulimin e veprave penale, identifikimin apo lokalizimin e autorëve të tyre, Policia e Shtetit merr, grumbullon, përpunon dhe dokumenton informacion dhe të dhëna nëpërmjet:*

*a) Mbikëqyrjes së veçantë zanore të komunikimeve jo-elektronike të peronave të dyshuar në ambiente publike apo të hapura për publikun me autorizim të prokurorit..."*

Në vijim të shqetësimeve të ngritura nga Prokuroria e Përgjithshme dhe disa organizata të shoqërisë civile, me qëllim për të adresuar sa më drejtë këto shqetësime, vijmë me ndryshimin sa sipër.

Këto ndryshime propozohen me qëllim që të garantohet respektimi i të drejtave dhe lirive të individit. Duke vendosur në dispozitë detyrimin që masa e veçantë, mbikëqyrja e veçantë zanore e komunikimeve jo -elektronike, të parashikuara në këtë akt ligjor, të lejohen me autorizim të prokurorit, krijojmë një garancj më tepër si dhe siguri juridike për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut duke pasur si qëllim sigurimin e një balance të drejtë dhe propocionale ndërmjet mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të individit dhe interesit të shtetit nga ana tjetër.

#### DEPUTETËT PROPOZUES

**Taulant BALLA**

**Alket HYSENI**

**Elena XHINA**

**Ulsi MANJA**